



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHEKRITEREVEPËRKUALIFIKIM**
(Kyprocesverbal ështëpërefektpublikimi bashkëmedokumentet etenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Rikonstruksioni i rrugës së fshatit “Drithas””

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45210000-2;

VLERA E FONDIT LIMIT: 14,674,995.00 (katërmbëdhjetë million e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta,

formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% e fondit limit, 0,4x14,674,995.00= 5,869,998.00(pesë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë Pa TVSH**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 ”Per tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2024.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistimin e taksave vendore”, i ndryshuar.

2.2.3 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit si dhe të shoqëruara me AktEkspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 7 337 497.5 (shtatë milion e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë pesë) lek pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht : 29 349 990 (njëzetë e nëntë milion e treqind e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lek pa TVSH.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me
:
- Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion;
- Akt kolaudimi objekti.

Në rastin e bashkimit të operatorëve pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët Ekonomikë, anëtar të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

- **Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.**
- **Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të

zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatorit ekonomik ofertues i është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE – së, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përlogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë* në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

NP – 1 A Punime gjurmimi në tokë

NP – 4 A Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, dhe pista aeroportuale

Për punimet speciale të ndërtimit

NS – 6 A Sinjalistikë rrugore jondriçuese

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM –

së Nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Të dhënat për liçencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", ku neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në liçencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP – 1	(Punime gjurmimi në tokë) Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore	Gjurmim dheu me ekskavator, 1.0 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke + Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	A (0 – 20 milion lekë)	123 807,96
NP– 4	(Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, dhe pista aeroportuale) Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët,	- Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	A (0 – 20 milion lekë)	14 028 955,35

	<p>pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me material të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim I ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi I çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore</p>	<p>- Shtrese stabilizant t=10cm - Shtrese binderi me granil gur kave,4cm,me makineri - Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri</p>		
NS – 6	<p><i>(Sinjalistikë rrugore jondriçuese)</i> Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare</p>	<p>Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjerësi 12 cm. Bikoponente (sprajt)</p>	<p>A (0 – 20 milion lekë)</p>	<p>522 231.43</p>

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) ing. Ndërtimi

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, diplomë universitare, librezë pune dhe CV**

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.
- **2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:**

- 1 (një) Teknik Ndërtimi të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.

- 3 (tre) manovradorë të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. (në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.)

- 2 (një) punëtor asfalti të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga ekuivalente me të, kontratë individuale pune si dhe librezë pune.

- 2 (një) shofer kamioni të pajisur me lejen e drejtimit përkatëse, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. (në rastin kur punonjësit Shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Manovratorët** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve të rënda që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zberthimi zë më zë i preventivit dhe afatit të punimeve rezultojnë të nevojshëm 3 manovratorë.
- **Shoferët** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve (kamionave) që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zberthimi zë më zë i preventivit, afatit të punimeve si dhe sasisë së materialeve që do të transportohen rezultojnë të nevojshëm 2 shoferë.

- **Punëtorët e asfaltit** janë të nevojshëm për shpërndarjen e asfaltit dhe binderit në rrugë. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit dhe afatit të punimeve rezultojnë të nevojshëm 2 punëtorë asfalti.

Kategorizimi i profesionit të punonjësve është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM 514 datë 15.09.2017, si më poshtë:

3119.15 Teknik ndërtimi (Grup njësi “Teknikë të shkencës së fizikë dhe inxhinierisë të pa klasifikuar diku tjetër” Kodi i profesionit: 3119) *Funksionet kryesore: Teknikët e këtij grupi kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Mbledhin të dhëna dhe japin mbështetje teknike për të kontribuar në përdorimin sa më efikas, të sigurtë dhe ekonomik të burimeve njerëzore dhe materiale, por edhe të pajisjeve. b) Kontribuojnë me anë të komenteve dhe sugjerimeve për vendosjen dhe planimetrinë e linjës së punës duke pasur parasysh procesin e caktuar që zhvillohet. c) Zbatojnë metoda pune dhe një seri veprimesh për të kryer detyrat e caktuara. d) Mbikëqyrin ecurinë dhe vazhdimësinë e metodave dhe planeve të punës së përcaktuar. e) Ndihmojnë në identifikimin e kërcënimeve për sigurinë dhe prezantojnë procedurat dhe pajisjet e sigurisë tek punonjësit e tjerë. f) Manovrojnë pajisje të ndryshme që prodhojnë produkte dhe nënprodukte të produkteve të para. g) Montojnë pajisjet dhe materialet sipas procedurës së përcaktuar për të prodhuar produktin final. h) Kryejnë teste laboratorike dhe shënojnë rezultatet në regjistrat përkatës. i) Përgatisin preventivë të detajuar të sasive dhe kostove të materialeve dhe punës së nevojshme për kryerjen e punës me saktësi dhe efikasitet. j) Monitorojnë aspektet teknike, rregullatore dhe ato të sigurisë së ndërtimit, instalimit, manovrimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të materialeve dhe pajisjeve. k) Ndihmojnë në dizejnimin dhe planifikimin e materialeve, metodave dhe planeve të punës. l) Respektojnë politikat e brendshme të punës dhe procedurat e hartuara nga Institucioni. m) Zbatojnë kodin e etikës të miratuar nga drejtuesit. n) Zbatojnë rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit. o) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.*

Kërkesat për punësim: a. Zakonisht kërkohet të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale; në disa raste një diplomë nga një shkollë e mesme e përgjithshme dhe eksperiencë pune disa vjeçare është gjithashtu e vlefshme.

Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda eksavatorit/ fadromës, makinave ngjeshëse dhe të asfaltimit) dhe shoferat e kamionit (Grupi-njësi (Profesioni) “Shoferë të makinave të rënda dhe kamionëve” Kodi i profesionit: 8332)

8332.03 Drejtues të makinave të asfaltimit

8332.06 Drejtues të makinave të ngjeshjes (rrula)

8332.14 Shofer kamioni

Kërkesat për punësim a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi të nivelit përkatës. b. Zakonisht kërkohet përfundimi i një shkolle profesionale në këtë fushë. c. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë profesion. d. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

7119.15 Punëtor asfaltimi në rrugë (Grup njësi - Punëtorë ndërtimi të paklasifikuar diku tjetër) y) Kryejnë asfaltime apo punime mirëmbajtje në rrugë;

Kërkesat për punësim: a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional për këtë profesion. b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur për çdo zë punimesh, bazuar në afatin përkatës të grafikut të punimeve.

Vendosja e këtyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlogaritur si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Kërkesa që punonjësit të jenë me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme.

Kërkesa për dëshmitë e drejtuesve të mjeteve të rënda bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit"

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës d) të pikës 2.3.3, të kritereve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë një numër mesatar prej jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) punonjës të siguruar për 3 (tre) mujorin e fundit (duke përfshirë edhe stafin teknik të sipërcituar). Për t’a vërtetuar këtë duhet të paraqesë :

- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore/ose Tatimore.
- Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Dega Rajonale Tatimore ku është i regjistruar subjekti.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve është vendosur bazuar në sasinë e çdo zëri punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zbërthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve janë gjithsej 1537.806 orë pune punëtori dhe 777,141 orë pune makineri, për të cilat nevojiten 10 (7+3) punonjës, ku përfshirë dhe stafin teknik nevojiten në total të paktën 12 (dymbëdhjetë) punonjës.

Objekti : RRUGA E FSHATIT RADHIME

PUNIME NDERTIMI								
NR	Nr.anal	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	Nje sia	Sasia	Ore pune punetori	Ore totale punetori	Ore pune makineri	Ore totale makineri
1	3.107/b+ 2.37/5a	Germim dheu me ekskavator, 1.0 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke + Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	261			0.033	8.613
2	3.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	315	0.340	107.100	0.14	44.100
3	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	4442	0.075	333.150	0.073	324.266
4	3.221/1	Shtresë binderi me granil gur kave, 4 cm me makineri	m2	4442	0.098	435.316	0.019	84.398
5	3.226/1	Shtresë asfaltbetoni me granil guri kave, 4 cm me makineri	m2	4442	0.095	421.990	0.017	75.514
4	3.942	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (sprajt)	ml	2402.5	0.1	240.250	0.1	240.250
					Ore Totale punetor	1537.806	Ore Totale makineri	777.141

6 javë pune * 5 ditë pune /java= 30 ditë pune
 30 ditë pune * 8 orë pune dita = 240 orë pune
 1537.806 orë totale punëtor / 240 orë pune total= 6.41 ≈ 7 punëtor
 777.141 orë totale makineri / 240 orë pune = 3.24 ≈ 3 manovrator

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues ≥ 18 ton	copë 2	Në pronësi ose me qira
Ekskavator 1.0 m3	copë 1	Në pronësi ose me qira
Ekskavator 2.0 m3	cope 1	Në pronësi ose me qira
Grejder	cope	Në pronësi ose me qira
Autobot	cope 1	Në pronësi ose me qira
Autobitumatriçe	copë 1	Në pronësi ose me qira
Asfaltoshtruese	copë 1	Në pronësi ose me qira
Rul (kompresor) me vibrim	copë 2	Në pronësi ose me qira
Spërkatës boje	copë 1	Në pronësi ose me qira
Kokore	copë 12	Në pronësi ose me qira
Jeleke	copë 12	Në pronësi ose me qira
Tabela sinjalizuese rrugore	copë 2	Në pronësi ose me qira
Kuti ndihme e shpejtë	copë 2	Në pronësi ose me qira

Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet :
 - a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Liçencë transporti;
 - f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
 - g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:
 - a) Kontrata e qerasë
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;

- e) Liçencë transporti (për transport mallrash për të tretë dhe me qera);
 - f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
 - g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira)
 - Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
 - Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës së makinerive.
 - Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
 - Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin"*.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues mbi 18 ton i referohet të gjitha analizave për transportin e materialit si dhe numrin 2 (dy) kamion i referohet sasisë dhe volumeve në preventiv.

- Ekskavator 1.0 m³ i referohet analizës “**Gërmim dhe me ekskavator, 1.0 m³, në kanale gjerësi > 2 m, tokë zak, kategoria IV, me shk në tokë**” kurse numri 1 (një) Ekskavator 1.0 m³ i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune.

- Ekskavator 2.0 m³ i referohet analizës “**Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri**” kurse numri 1 (një) Ekskavator 2.0 m³ i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune.

-Grejder i referohet analizës “**Shtrese stabilizant t=10cm**” kurse numri 1 (një) Grejder i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune.

-Autobot i referohet analizës “**Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri**”, “**Shtrese stabilizant t=10cm**” kurse numri 1 (një) Autobot i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune.

- Autobitumatriçe i referohet analizave “**Shtresë binderi me granil gur kave 4cm, me makineri**” dhe “**Shtresë asfaltobetonit me granil guri kave 4cm, me makineri**”, kurse numri 1 (një) autobitumatriçe i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune.

- Asfaltoshtruese i referohet analizave “**Shtresë binderi me granil gur kave 4cm, me makineri**” dhe “**Shtresë asfaltobetonit me granil guri kave 4cm, me makineri**”, kurse numri 1 (një) asfaltoshtruese i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune.

- Rul (kompresor) me vibrim i referohet analizave “**Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës përhapur e ngjeshur me makineri**”, “**Shtresë stabilizantë t=10 cm**”, “**Shtresë asfaltobetonit me granil guri kave 4cm, me makineri**”, “**Shtrese binderi me granil kave, 4 cm, me makineri**”, kurse numri 2 (dy) Rul (kompresor) me vibrim i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune.

- Spërkatës boje i referohet analizës “**Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm. Bikoponente (sprajt)**”, kurse numri 1 (një) spërkatës boje i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune dhe volumeve në preventiv.

- Mjetet e tjera që kërkohen i referohen sigurisë dhe shëndetit në kantier. Numri i kërkuar për secilin nga këto mjete i referohet numrit të personelit të kërkuar.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standartave, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentat konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet oraganizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë:

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001:2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë
- BS ISO 39001:2012 Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë. Çertifikatat e lëshuara nga organizma të pa akredituara do të konsiderohen kusht skualifikimi.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga

madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

BS ISO 39001:2012 Kjo certifikatë mundëson që kompanite të punojnë me sistemet e qarkullimit rrugor, të reduktojnë dhe të përjashtojnë rreziqet e humbjes të jetes dhe plagosjeve në lidhje me aksidentet gjatë procesit të punës.

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës dhe shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.